

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	PE pret ndryshimin e ligjit për zonat e mbrojtura deri në fund të vitit
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/21/pe-pret-ndryshimin-e-ligjit-per-zonat-e-mbrojtura-der-i-ne-fund-te-vitit/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:53:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	21 shtator 2026, 14:32:22 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	236f1ba8c28e75efbdc2ac5eee73a1aec7906815b599c96cdd3de76acc91a4f7
TEKSTI	f2729998cef0730f58761d29c45e27a6a81a93aee01d8e7cdc7510254dba5501
PAMJA	1f4cacc8e0c45f7ec125c1d60aa999da76b3c385afd987ad770c96ac40ea3c35

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4d6cee59d5a9da82fb647b19c7268be394f28275bfbe57ffc771faae591d620d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4d6cee59d5a9da82fb647b19c7268be394f28275bfbe57ffc771faae591d620d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TEMA:

BELINDA BALLUKU

ERION VELIAJ

VETING

SPAK

MJEDISI

EDI RAMA

SALI BERISHA

ZGJEDHJE 2025

Kryefaqja Lajme

PE pret ndryshimin e ligjit për zonat e mbrojtura deri në fund të vitit

Edhe pse qeveria dhe mazhoranca socialiste nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për shfuqizimin e neneve që i hapën rrugë betonizimit të zonave të mbrojtura, eurodeputetët kërkojnë që rishikimi i ligjit të bëhet deri në fund të vitit si detyrim ndaj negociatave për anëtarësim në BE.

nga Blerina Gjoka — 2 days më parë në Artikulli kryesor, Artikulli kryesor Lajme, Lajme

Koha e leximit: 2 min lexim

AA 0



Takimi i 22-të i Komitetit të Përbashkët Parlamentar të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri. Foto: LSA.

Parlamenti European pret që Shqipëria të ndryshojë ligjin për zonat e mbrojtura deri në fund të këtij viti në kuadër të zbatimit të rezolutës së këtij parlamenti dhe kërkesave që lidhen me negociatat e anëtarësimit në Bashkimin European.

Çështja ishte pjesë e diskutimeve gjatë takimit të 22-të të Komitetit të Përbashkët Parlamentar të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri.

Eurodeputetja Isabel Wiseler-Lima shprehu të hënën në Tiranë besimin se këto amendime do të jenë në axhendën e Kuvendit së shpejti si detyrim për përbushjen e kërkesave të shtrura në një rezolutë të PE dhe standardeve të legjisllacionit european.

"Jam e bindur se kjo do të merret parasysh dhe se amendamenti do të miratohet deri në fund të vitit," tha ajo për BIRN pas këtij takimi, duke shtuar se shpresonte se kjo çështje "do të shkonte në drejtimin e duhur".

Eurodeputetja Wiseler-Lima e lidh besimin e saj se kjo çështje do të adresohet shpejt nga qeveria shqiptare me kërkesat për përmbylljen e negociatave për Kapitullin 27, që mbulon mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

Në kulmin e protestave kundër projektit turistik në Zvërnec, i miratuar nga qeveria në bazë të ndryshimeve të reja ligjore të bëra në mënyrë të njanshme dhe pa konsultim në vitin 2024, PE i kërkoi qeverisë shqiptare të vendosë menjëherë një moratorium për procedurat e reja të lejeve, punimet e ndërtimit dhe ndërhyrjet zhvillimore në zonat e mbrojtura, deri në shfuqizimin e dispozitave të papajtueshme të ligjit të ndryshuar për zonat e mbrojtura.

Që nga miratimi i rezolutës në qershor, qeveria shqiptare dhe mazhoranca parlamentare nuk kanë ndërmarrë asnjë hap konkret për shfuqizimin e dispozitave që i hapën rrugën ndërtimeve masive turistike në zonave bregdetare, mes tyre dhe projekti i Zvërnecit.

Wiseler-Lima kërkoi gjithashtu që autoritetet shqiptare të dëgjojnë zërin e qytetarëve që protestojnë prej muajsh në shesh dhe që parlamenti mos të bëhet mburojë e imunitetit për të kërkuarit nga drejtësia.

"Roli i parlamentit nuk është gjithmonë që të aprovojë ligje, por të dëgjojë edhe zërat e qytetarëve. Qytetarët nia të fundit na dërronin në sinjal të qartë dhe duhet të

Kuvendi injoron konsultimet publike, fut në shqyrtim Reformën Territoriale

16:11 | 23/09/2026

Avokati i Netanyahu-t mes drejtuesve të kompanisë që prodhon dronë izraelitë në Serbi

15:08 | 23/09/2026

Eurodeputetja i kërkon qeverisë që të mos zvarrisë ndryshimet në ligjin 21/2024

14:26 | 23/09/2026

A mund të ndjekim Hungarinë në hetimin e pasurive të zyrtarëve?

12:20 | 23/09/2026

Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë

06:20 | 23/09/2026

Rama shkarkon Hysenin, por shmang përgjegjësitë për skandalin në SHISH

16:31 | 22/09/2026

dëgjojen", tha ajo gjatë diskutimit të saj në tryezën e përbashkët.

Ndërsa eurodeputetja Chiara Gemma e lidhi debatin për zonat e mbrojtura me modelin e zhvillimit ekonomik, duke argumentuar se rritja nuk mund të përqendrohet vetëm përgjatë bregdetit, ndërsa zonat e brendshme përballen me shpopullim dhe mungesë mundësisish.

Nga mazhoranca, deputeti Pirro Vengu tha se mazhornaca nuk kishte 'kompleks' për të ndryshuar ligjet, por se kjo do të vendoset në kuadër të negociatave për kapitullin 27.

Sipas tij, duhet të parë si e drejtë dhe kërkesa e banorëve të zonës që kërkojnë mbrojtjen e natyrës, ashtu edhe e sipërmarrësve apo banorëve të tjerë që kërkojnë zhvillim. "Politika duhet të pajtojë interesat kur ato përplasen," tha ai.

Për deputetët e opozitës, anëtarë të këtij komiteti, qëndrimi i Parlamentit Europian ishte i qartë dhe se kërkesa për shfuqizimin e ndryshimeve të ligjit për zonat e mbrojtura duhet të zbatohet sa më parë nga Kuvendi.

Etiketa: Chiara Gemma Isabel Wiseler-Lima Ligji 21/2024 Parlamenti Europian
Pirro Vengu Qeveria shqiptare Zonat e Mbrojtura

Reporter.al

Opinion
Reportazhe
Analiza
Investigime
Lajme
Blog
Rajoni

Rreth nesh
Stafi
Kontaktimi
Ankesa dhe Korrigjime
Politika e privatises dhe rregulla te tjera
Letra per redaktorin

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN
Dev by [Slida.PRO](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.